



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 87  
Prishtinë, më 6.6.2024, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi, Doarsa Kica-Xhelili dhe Time Kadrijaj.

**Munguan:** Gazmend Gjyshinca dhe Bahrim Shabani.

**Të pranishëm në takim:** z. Hristo Gudjev, ambasador i Republikës së Bullgarisë në Kosovë, dhe z. Milen Hristov, Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Bullgarisë në Kosovë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Albana Bucaliu, Alisa Thaçi, Besarta Pllana, Leudita Mejzini dhe Adriana Osmani, Kuvendi i Kosovës.

**Nga Zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29 prill, 21 e 22 maj 2024;
3. Takim i Komisioni me z. Hristo Gudjev, ambasador i Republikës së Bullgarisë në Kosovë;
4. Të ndryshme.

**3. Takim i komisioni me z. Hristo Gudjev, ambasador i Republikës së Bullgarisë në Kosovë**

**Arbëreshë Kryeziu-Hyseni**, shprehu falënderimet ndaj Bullgarisë për njohjen e Kosovës, si dhe trajtimit të barabartë të shtetit të Kosovës me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, posaçërisht këtë vit për KE, por edhe në tryezat e tjera multilaterale. Po ashtu e falënderoi ambasadorin për mbështetjen e vazhdueshme të Bullgarisë ndaj Kosovës në institucionet e BE-së, për liberalizimi e vizave, i cili u ka mundësuar qytetarëve të Kosovës të vizitojnë Bullgarinë. Ajo vlerësoi se Bullgaria duhet të vazhdojë ta përkrahë Kosovën edhe në të ardhmen, që të jetë pjesë e BE-së, Këshillit të Evropës, në NATO, si dhe në organizatave tjera ndërkombëtare.

**Hristo Gudjev**, tha se Bullgaria ka qenë një mbështetëse e madhe e Kosovës, duke ofruar ndihmë që nga operacionet e NATO-së. Autoritetet bullgare kanë lejuar aeroplanët e NATO-s, të fluturojnë mbi territorin e Bullgarisë gjatë operacioneve. Bullgaria ishte ndër vendet e para që njohën pavarësinë e Kosovës dhe që ka themeluar ambasadën e saj në Prishtinë. Gjatë kryesimit të Këshillit të BE-së nga Bullgaria, Kosova ishte ftuar si një vend i barabartë me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, për të marrë pjesë në takimet e përbashkëta me BE-në. Në procesin e liberalizimit të vizave, bëri të ditur se Bullgaria ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe njoftoi se zyrtarët në ambasadë kanë lëshuar shumë viza për qytetarët e Kosovës, duke përballuar një fluks të madh kërkesash. Pas liberalizimit të vizave, qytetarët kosovarë kanë pasur mundësinë të udhëtojnë më lirshëm në Bullgari dhe kanë shprehur interes të madh për këtë vend. Një shembull i fundit i bashkëpunimit, tha se është linja e re ajrore nga Prishtina në Varna, që u lejon qytetarëve të Kosovës të vizitojnë plazhet dhe pjesët e tjera të Bullgarisë. Ambasadori theksoi se Bullgaria ka mbështetur Kosovën në Këshillin e Evropës dhe në përpjekjet e saj për t'u bërë anëtare e asociuar e Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

**Arbëreshë Kryeziu-Hyseni**, theksoi se Bullgaria e ka mbështetur Kosovën në proceset e ndryshme dhe gjithashtu pas zgjedhjeve të reja në qershor, Kosova prapë e ka marrë mbështetjen e Bullgarisë, sepse është duke hyrë në një proces të rëndësishëm të integritetit dhe na duhet mbështetja e Bullgarisë dhe e vendeve të cilat besojnë se Kosova meriton të jetë pjesë e BE-së dhe e organizatave të tjera ndërkombëtare.

**Xhavit Haliti**, shprehu kënaqësinë për takimin me ambasadorin e Bullgarisë dhe bëri të ditur se ka qenë në Bullgari për takimin e Asamblesë Parlamentare të NATO-së në Sofje. Ai vuri në dukje ndryshimet pozitive në Sofje, krahasuar me vizitat e tij të mëparshme, përfshirë kohën kur Bullgaria u bë pjesë e BE-së. Z. Haliti theksoi se Bullgaria ka qenë gjithmonë një destinacion për kosovarët, veçanërisht për pushime në Varna dhe qendrat e skijimit, madje edhe gjatë kohës së komunizmit. Më tej, bëri të ditur se marrëdhëniet midis Bullgarisë dhe Kosovës datojnë që nga shekujt e kaluar, duke përmendur se proceset dhe rreziqet kanë ndryshuar me kohën, sidomos tani që Evropa përballet me kërcënime nga Rusia. Bullgaria, si pjesë e vijës së parë të mbrojtjes në Evropë, sipas asaj se çfarë është thënë në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, ka marrë masat e duhura për të mbrojtur veten dhe kontinentin. Në lidhje me situatën nëpër të cilën është duke kaluar Kosova, shprehu shqetësimin e tij, duke theksuar për sfidat dhe përpjekjet e vazhdueshme për integritetin e Kosovës në institucione ndërkombëtare, përfshirë dështimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për të shqyrtuar kërkesën e Kosovës. Ai nënvizoi rëndësinë e mbështetjes së Sofjes zyrtare për heqjen e masave ndaj Kosovës dhe për vazhdimin e mbështetjes për integritetin e Kosovës. Ai përmendi gjithashtu investimet bullgare në Kosovë, pas luftës, dhe thekson nevojën për rritjen e lidhjeve ekonomike dhe zhvillimin e turizmit. Z. Haliti shprehu besimin se Bullgaria duhet të bëjë fushatë në Kosovë për ofertat turistike, duke e bërë turizmin një synim të rëndësishëm të bashkëpunimit mes dy vendeve.

**Hristo Gudjev**, lidhur me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, theksoi se Këshilli i Ministror nuk e ka refuzuar kërkesën e Kosovës për anëtarësim, por e ka shtyrë vendimin. Ai bëri të ditur se vonesa ishte për shkak edhe kundërshtimeve nga një fqinj i Kosovës, ndërsa garanton mbështetjen e Bullgarisë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, pas raportit pozitiv nga znj. Bakoyannis. Sa i përket masave, tha se Bullgaria mbështet heqjen e masave të imponuara ndaj Kosovës, si dhe njoftoi se Presidenti i Bullgarisë ka vizituar Kosovën, si shenjë të mosrespektimit të masave të imponuara ndaj Kosovës. Z. Gudjev tha se Bullgaria e ka mbështetur anëtarësimin e Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe theksoi se vendet kanë një bashkëpunim të mirë bilateral. Në fund, ambasadori shprehu mbështetjen e tij për forcimin e marrëdhënieve ekonomike, duke përmendur krijimin e një asociacioni bullgar-kosovar në Bullgari dhe planin për të krijuar një të tillë në Kosovë. Ai thekson se disa kompani bullgare po investojnë në Kosovë dhe shpreson për rritjen e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

**Yllza Hoti**, e falënderoi ambasadorin për takimin me Komisionin. Theksoi se pajtohet me rëndësinë e marrëdhënieve ekonomike dhe shpreh mirënjohje për mbështetjen e Bullgarisë, veçanërisht gjatë krizës së COVID-it. Ajo theksoi se si vende të vogla duhet të mbështeten te njëri-tjetri, në kohë krizash. Ajo tha se bashkëpunimi ekonomik mund të rritet në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT), duke përmendur se Bullgaria ka një rritje të madhe në këtë fushë dhe eksporton shumë shërbime në vendet evropiane dhe në SHBA. Po ashtu, theksoi se ka pasur shkëmbime të mëparshme në këtë sektor midis Kosovës dhe Bullgarisë dhe propozoi organizimin e një konference të ngjashme edhe në Kosovë. Heqja e regjimit të vizave do të ndihmojë shumë në këtë bashkëpunim, duke eliminuar barrierat. Kjo do t'i lehtësojë shkëmbimet dhe do të rrisë potencialin e bashkëpunimit në sektorin e ICT-së. Znj. Hoti, gjithashtu theksoi nevojën për më shumë programe të shkëmbimit akademik midis universiteteve të dy vendeve. Ajo sugjeroi për zgjerimin e këtyre shkëmbimeve për të rritur mundësitë akademike dhe për të forcuar lidhjet arsimore midis Bullgarisë dhe Kosovës. Në fund, theksoi rëndësinë e vizitave të të rinjve bullgarë në Kosovë, për t'u familjarizuar me jetën këtu, pasi që në media ndonjëherë paraqitet një pamje e gabuar e Kosovës dhe vizitat direkte mund të ndryshojnë perceptimet, duke treguar se Kosova funksionon si vendet tjera evropiane.

**Hristo Gudjev**, lidhur me bashkëpunimin në fushën e ICT-së, njoftoi se Bullgaria po bën çfarë mundet, për të mbështetur këtë sektor. Konferenca e përmendur, e cila u mbajt dy vite më parë, ka ftuar sektorin kosovar të ICT-së, për të marrë pjesë dhe se çdo vit organizohen konferenca në Bullgari, ku Kosova është pjesëmarrëse. Sa i përket shkëmbimeve universitare, ambasadori bëri të ditur se shumë universitete nga Bullgaria dhe Kosova kanë lidhje të drejtpërdrejta dhe Bullgaria ka programe për të rinjtë me origjinë bullgare nga Kosova, të cilët mund të studiojnë në Bullgari. Si pjesë e BE-së, Bullgaria po bën përpjekje për të ndihmuar në zhvillimin e Kosovës, duke preferuar të punojë me autoritetet lokale, për shkak të ndërlikimeve që lidhen me autoritetet qendrore dhe Parlamentin, të cilët nganjëherë nuk marrin vendime për arsye politike. Në fushën e arsimit, Bullgaria mbështet gjimnazet, shkollat dhe çerdhet në Kosovë.

**Ariana Musliu-Shoshi**, shprehu mirënjohjen për ndihmën e Bullgarisë në proceset e rëndësishme për Kosovën, si para pavarësisë, ashtu edhe pas saj. Lidhur me Këshillin e Evropës, theksoi se Bullgaria e ka ndihmuar shumë Kosovën, por theksoi se ministri i Punëve të Jashtme i Bullgarisë ndan qëndrimin e njëjtë me vendet tjera të BE-së, që është e kuptueshme. Ajo pyeti se si e shikon Bullgaria të ardhmen e Kosovës dhe mbështetjen e saj në Këshillin e Evropës. Gjithashtu, pyet nëse asociacioni i komunave me shumicë serbe mbetet një kusht nga ana e Bullgarisë. Znj. Musliu-Shoshi, po ashtu kërkoi mendimin e ambasadorit mbi mënyrën e heqjes së sanksioneve të BE-së ndaj Kosovës, duke theksuar që Kosova është i vetmi vend, përveç Bjellorusisë nën këto sanksione. Po ashtu, pyeti nëse ambasadori ka ndonjë informacion lidhur me heqjen e këtyre masave dhe si mund të ndodhë kjo.

**Hristo Gudjev**, bëri të ditur se përveç Kosovës dhe Bjellorusisë, edhe Rusia është subjekt i sanksioneve. Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës (KE), theksoi se krijimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe nuk është parakusht për anëtarësim. Disa vende të BE-së ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por ka shenja pozitive nga Spanja. Z. Gudjev shprehu besimin se Rusia është duke u përpjekur që të krijojë një front të dytë në Ballkan, për të larguar vëmendjen nga Ukraina, prandaj Bullgaria ka dyfishuar pjesëmarrjen e saj në KFOR. Lidhur me sanksionet e BE-së ndaj Kosovës, ai tha se përfaqësuesi i lartë do të prezantojë një raport në Këshillin Ministror dhe shumë vende evropiane nuk janë në favor të këtyre masave, duke besuar se sulmi në Banjskë, tregon qartë fajtorët e situatës në Kosovë. Në lidhje me asociacionin, ai thekson se vendimet duhet të merren kur Kosova e vlerëson të përshtatshme dhe Bullgaria nuk dëshiron të imponojë asgjë. Ai shpreh besimin se BE-ja do të heqë sanksionet dhe Serbia tashmë përballlet me kushte të reja sipas kushtit 35.

**Doarsa Kica-Xhelili**, njoftoi si fëmijë ka vizituar Bullgarinë, ku kishte shumë vizitorë nga Kosova. Të rëndësishme i cilësoi shkëmbimet akademike dhe profesionale ndërmjet Kosovës dhe Bullgarisë. Ajo theksoi se megjithëse ekzistojnë disa shkëmbime studentore, është e rëndësishme të përmirësohet cilësia e arsimimit. Më tej, shtoi se universitetet private në Kosovë shpesh kanë mungesë kapacitetesh cilësore, dhe propozoi që këto shkëmbime të fokusohen më shumë në universitetet publike. Këto shkëmbime tha se do të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve në sistemin gjyqësor të Kosovës, për t'iu përmbajtur standardeve të Gjykatës Evropiane, duke pasur parasysh edhe autorët bullgarë, të cilët ishin shumë të qartë dhe praktikë. Ajo shprehu shqetësimin se pas anëtarësimit në Gjykatën Evropiane, Kosova mund të përballlet me shumë raste ligjore, të ngritura nga qytetarët e saj, për shkak të gabimeve të gjykatave të Kosovës, gjë që mund të rezultojë në detyrime financiare për shtetin. Sa i përket mosnjohjes nga Spanja, tha se rasti i Spanjës nuk ka asgjë të bëjë me Kosovën, porse propaganda serbe ka ndikuar në perceptimin ndërkombëtar të Kosovës, duke përmendur se ministri i propagandës i Slobodan Milosheviçit është tani president i Serbisë dhe propaganda është intensifikuar. Për këtë arsye, tha se Kosova ka nevojë për mbështetje dhe lobim nga miqtë evropianë, për të kundërshtuar këtë propagandë dhe për të përmirësuar marrëdhëniet diplomatike. Ajo po ashtu kërkoi mbështetje nga Bullgaria për të përdorur marrëdhëniet e saj diplomatike, për të lobuar në favor të Kosovës, veçanërisht në vende që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Në fund, znj. Kica-Xhelili pyeti ambasadorin për politikën dhe strategjitë e Bullgarisë për tërheqjen e investimeve të huaja, veçanërisht në sektorin e IT-së. Më tej, tha se Bullgaria ka tërhequr shumë biznese të huaja, që kanë hapur degët e tyre dhe janë duke punësuar një numër të madh të njerëzve të rinj. Ajo pyeti se nëse ky sukses është rezultat i masave specifike të ndërmarra nga Bullgaria, apo nëse ka qenë thjesht një situatë e favorshme financiare që ka tërhequr këto investime.

**Hristo Gudjev**, sa i përket lobimit, tha se Bullgaria është duke lobuar për Kosovën. Sa i përket bashkëpunimit ndëruniversitar, ai theksoi se ka një problem, veçanërisht në kontekstin e marrëveshjes mes Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Sofjes. Në periudhën e komunizmit, Universiteti i Sofjes kishte disa qendra të pavarura, të cilat pas rënies së komunizmit, u vetëquajtën universitete. Kjo ka krijuar sfida për bashkëpunim, pasi rektori i Universitetit të Sofjes refuzon nënshkrimin e marrëveshjeve, sidomos në fushën e juridikut. Ambasadori theksoi se përveç luftës në Kosovë, Evropa ka pasur një periudhë të gjatë paqej, që nga Lufta e Dytë Botërore, e cila tani është kërcënuar nga ambicet imperialiste të Rusisë, duke thyer kështu status quo-në e paqes në kontinent.

**Arbëreshë Kryeziu-Hyseni**, bëri të ditur se në Konferencën Rajonale Ndërparlamentare, që u organizua në nëntorin e vitit të kaluar, një deputet nga Komisioni për Çështje Evropiane i Parlamentit të Bullgarisë, mori pjesë përmes një video-mesazhi. Ajo kërkoi nga ambasadori, që të përcjellë ftesën te deputetët e Parlamentit të Bullgarisë, që të gjejnë kohë të vijnë në Kosovë, ku do të ketë mundësi për të diskutuar.

**Hristo Gudjev**, falënderoi për ftesën dhe theksoi se Bullgaria është në proces zgjedhor dhe takimi në mes të komisioneve mund të mbahet pas formimit të komisioneve parlamentare. Po ashtu, tha se grupet e miqësisë midis parlamenteve të dy vendeve, janë një mjet për thellimin e bashkëpunimit, duke shprehur mbështetjen për ndërtimin e një bashkëpunimi të drejtpërdrejtë midis tyre. Shprehu mendimin se vizitat bilaterale duhet të vazhdojnë dhe të rritet bashkëpunimi në mes të dy vendeve, pasi që shumë njerëz në Bullgari nuk kanë njohuri për Kosovën.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

Kryetare e Komisionit